

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Travel India El - Shaddai” shpk,**

Në Tiranë, sot më datë 22.11.2021, une i poshteshënuari Shaji Appukuttan, i datëlindjes 1.04.1973, lindur ne Pattom Kerala,Trivandrum Indi,identifikuar me dokument identifikimi:pasaporte me numër personal ,K9772019 me cilësinë e “ortakut themelues”deklarojmë se me vullnet të lirë të plotë, mbështetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregëtare me përgjegjësi të kufizuar, **“Travel India El - Shaddai” shpk.**

**Neni 1**

**Emri, Forma**

Shoqëria do të ketë emrin**“Travel India El - Shaddai” shpk,** dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” e quajtur më poshtë “Shoqëria”.

**Neni 2**

**Personaliteti juridik**

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

**Neni 3**

**Selia**

Shoqëria **“Travel India El - Shaddai” shpk** e ka seline në adresë: “Rruga Bilal Golemi Nr 28,Shkalla 1 Hyrja 2,Njesia 5,Tirane” dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve.

**Neni 4**

**Objekti i veprimtarisë**

Objekti i ushtrimit të veprimtarisë per shoqërine **“Travel India El - Shaddai” shpk** është:Agjensi udhëtimesh brenda dhe jashtë Shqiperisë.

**Neni 5**

**Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.

**Neni 6**

**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërise është 100,000 lekë, i ndarë në 1(nje) kuote e cilat zotërohet si më poshtë:

Shaji Appukuttan, i datëlindjes 1.04.1973, lindur ne Pattom Kerala,Trivandrum Indi,identifikuar me dokument identifikimi:pasaporte me numër personal ,K9772019, zotëron 1(një) kuote me vlerë 100,000 lek që përbën 100 % të kapitalit të shoqërisë.

SHAJI APPUKUTTAN



Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë ,pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta. Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

#### Neni 7

##### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj ne Qendren Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

#### Neni 8

##### Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

SHAJI APPUKUTIAN



**Neni 9**  
**Administrimi**

Administrator i shoqërisë “**Travel India El - Shaddai**” shpk është:

Shaji Appukuttan, i datëlindjes 1.04.1973, lindur ne Pattom Kerala,Trivandrum Indi,identifikuar me dokument identifikimi:pasaporte me numër personal ,K9772019

Administratori i shoqërisë është i emëruar për një afat 5(pesë) vjeçar.Data e emërimit te tij përkon me datën e themelimit te shoqërisë qe eshte data 22.11.2021.

**Neni 10**  
**Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 11**  
**Dispozita perfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera te njëjta juridike.Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga ortakët themelues të shoqërisë tregtare “**Travel India El - Shaddai**” shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

**ORTAKET THEMELUES**  
**Shaji Appukuttan**



Tiranë, më datë 22.11.2021